

## EMËRTIMI I ÇERTIFIKATAVE

1. Çdo person fizik/juridik, është i detyruar të kryejë shërbime, vetëm pasi të jetë pajisur me çertifikatën, për të drejtën e ushtrimit të profesionit, si edhe llojit të shërbimit.
2. “Çertifikata”, është dokumenti i cili prezantohet nga çdo person fizik/juridik. Dokumenti përmban emrin e personit juridik, emrin, atësinë, mbiemrin e përfaqësuesit ligjor dhe të drejtuesve teknikë, llojin e shërbimit, si dhe gjeneralitete të tjera që do të përcaktohen në rregulloret e Urdhrit, sipas përcaktimeve në ligjin organik.
3. Çdo subjekt “fizik”, “juridik”, apo individë që kërkon të kryejë një shërbim në fushën e veprimtarisë hidroteknike, detyrimisht duhet të kontraktojë për të përfituar këtë shërbim subjektet sipas profesionit hidroteknik në zbatim të plotë të këtij ligji.
4. Çdo subjekt fizik/juridik privat që ushtron aktivitetin për zbatimin e punimeve që është i pajisur me çertifikatë në “Menaxhim Projekti”, mund të pajiset edhe me çertifikatën për “Studim dhe Monitorim” dhe “Projektim”, por jo me çertifikatat: “Mbikëqyrje dhe Kolaudim” dhe “Vlerësim dhe Ekspertize Teknike”, për të shmangur konfliktin e interesit profesional.
5. Çdo subjekt fizik/juridik privat që ushtron aktivitetin me çertifikatën “Studim dhe Monitorim”, “Projektim”, “Mbikëqyrje dhe Kolaudim”, “Vlerësim dhe Ekspertize Teknike”, nuk mund të pajiset me çertifikatë në “Menaxhim Projekti”.
6. Çdo subjekt juridik shtetëror që kanë objekt dhe ushtrojnë nëpërmjet inxhinierëve hidroteknik profesionin në fushat e veprimtarisë hidroteknike, mund të pajisen vetëm me çertifikatën “Projektim” dhe me “Menaxhim Projekti”.
7. Agjencitë shtetërore që kanë objekt administrimi dhe monitorimi dhe që kryejnë shërbim nëpërmjet inxhinierëve hidroteknik në fushat e veprimtarisë hidroteknike, mund të pajisen vetëm me çertifikatë “Vlerësim dhe Ekspertize Teknike”.
8. Universitetet (Fakultetet/Departamentet) që ushtrojnë profesionin në fushat e veprimtarisë hidroteknike mund të pajisen vetëm me çertifikatë “Studimi dhe Monitorimi”.

## **Legjitimiteti i Çertifikatave**

Në çdo rast personi fizik/juridik do të shoqërojë punën e tij me çertifikatën përkatëse për ushtrimin e profesionit sipas objektit, ky dokument është i printueshëm nga sistemi i Rregjistrimit të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik. Çertifikata përveç gjeneraliteteve të saj mbasi të printohet duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor dhe teknik dhe vetëm atëherë do të ketë legjitimitet të plotë për t'ju drejtuar të tretëve.